



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 2 mars 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratua kërkesa e shoqërisë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.

U vendos zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a., si dhe përfundoi procedura për shqyrtimin e kontratave të kredisë me nr. 4152 rep., nr. 3125 kol., datë 13.10.2021, si dhe kontratës me nr. 4896 rep., nr. 3198 kol., datë 24.08.2022, si pjesë e vendimmarrjes së filluar me vendimin nr. 345, datë 23.12.2025.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “DION ENERGY” për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Nuk pati çështje të tjera për shqyrtim.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.